

VENDIM
Nr.366, datë 6.5.2020

PËR SHEMBJEN E GJASHTË OBJEKTEVE TË DHËNA ME QIRA ME KONTRATËN E QIRASË NR.1937 REP., NR.1388 KOL, DATË 15.8.2019, ME TARIFËN 1/EURO KONTRATA, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË “BLU IMPERIAL”, SH.P.K., SI QIRAMARRËS, NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 7, kreut VIII, të vendimit nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shembjen e gjashtë objekteve me emërtimet nr.1 “Truproja”, nr.2 “Banjo”, nr.3 “Depo amartimi”, nr.4 “Depo”, nr.5 “Depo”, nr.6 “ Depo armatimi”, me sipërfaqe totale 1354.39 m², të dhëna me qira me kontratën e qirasë nr.1937 rep., nr.1388 kol, datë 15.8.2019, me tarifën 1/euro kontrata, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë “Blu Imperial”, sh.p.k., si qiramarrës, miratuar me vendimin nr.508, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, pjesë të pasurisë nr.94, me emërtimin “Ish-grupdepot e repartit ushtarak nr.4025”, me sipërfaqe të përgjithshme 353 686 m², nga ku sipërfaqe nën objekt 8553.58 m², tunele (5 tunele) me sipërfaqe 3434.6 m², dhe sipërfaqe funksionale 341 697,82 m², zona kadastrale 3081, me vendndodhje Qafëmollë, Dajt, Tiranë, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas tabelës nr.1 për nxjerrjen jashtë përdorimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

TABELA NR.1

Ndërtesa në administrim të Repartit Ushitarak nr.4001, që miratohet për nxjerrjen nga përdorimi, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. _____, datë _____, 2019

Nr	Reparti që e administro	Nr.pronës/ Vendodhja	Emërtimi I ndërtesës	Viti ndërtimit	Sipërfaqja (m2)	Vlera Fillestare Lekë	Amortizimi Lekë	Vlera e mbetur Lekë
1	Reparti Ushitarak nr. 4006	Prona nr.94, "N/Reparti ushtarak nr.4006" Qafë-Mollë, Tiranë	Objekti nr.1 "Truproja"	1962	201.75	355000	160961	194039
2	Reparti Ushitarak nr. 4006	Prona nr.94, "N/Reparti ushtarak nr.4006" Qafë-Mollë, Tiranë	Objekti nr.2 "Banjo"	1978	24.5	357000	127827	229173
3	Reparti Ushitarak nr. 4006	Prona nr.94, "N/Reparti ushtarak nr.4006" Qafë-Mollë, Tiranë	Objekti nr.3 "Depo armatimi"	1978	192	357000	127827	229173
4	Reparti Ushitarak nr. 4006	Prona nr.94, "N/Reparti ushtarak nr.4006" Qafë-Mollë, Tiranë	Objekti nr.4 "Depo"	1978	372.07	417000	149310	267690
5	Reparti Ushitarak nr. 4006	Prona nr.94, "N/Reparti ushtarak nr.4006" Qafë-Mollë, Tiranë	Objekti nr.5 "Depo"	1978	372.07	417000	149310	267690
6	Reparti Ushitarak nr. 4006	Prona nr.94, "N/Reparti ushtarak nr.4006" Qafë-Mollë, Tiranë	Objekti nr.6 "Depo armatimi"	1978	192	362860	129925	232935